



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGIJË

VENDIM

Nr. 162 Datë 07.12.2012

PËR

**DISA NDRYSHIME TË KONTRATËS SË SHITBLERJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE MIDIS KESH sh.a dhe PVE TË MIRATUAR
ME VENDIMIN NR. 80, DATË 23.10.2012 TË BORDIT TË
KOMISIONEREVE TË ERE-S**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 dhe nenit 9, të Ligjit 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike“ i ndryshuar, pikës 4.13 gërma ”A”, pika 5 dhe gërma “F”, pika 7, të Modelit të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike, të miratuar me VKM nr. 338, datë 19.03.2008, të ndryshuar, nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë në mbledhjen e tij të datës 07.12.2012, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut,

Konstatoi se:

- Palët e kësaj kontrate KESH sh.a/FPSH dhe Prodhuesve të Vegjël të Energjisë PVE, janë të liçensuara nga ERE me vendimet respektive.
- Marrëdhënia ndërmjet KESH sh.a (FPSH) dhe Prodhuesve të Vegjël të Energjisë (PVE) është një marrëdhënie e rregulluar nga ERE.
- Është në autoritetin e ERE-s përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve respektive ndërmjet pjesëmarrësve të tregut si dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet tyre.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e ndryshimeve në “Modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH (FPSH) dhe Prodhuesve të Vegjël të

Energjisë (PVE)”, të miratuar me vendimin nr. 80, datë 23.10.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI

Teksti i ndryshimeve te kontratës:

Pas nenit 3.1, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: *“Pavarësisht detyrimit që ka KESH për të blerë të gjithë energjinë elektrike të prodhuar nga shitësi, shitësi ka të drejtë të shesë të gjithë ose pjesë të energjisë së prodhuar subjekteve të tjerë të ndryshëm nga KESH, në sasi të dhe mënyrat e zgjedhura nga vete shitësi”. Grafiku i lëvrimit për energjinë që do të shitet në tregun e pa rregulluar do të jetë në bande sipas profilit 00:00 – 24:00.*

Ne nenin 5, pas pikës 5.2 shtohet pika 5.2/i, me këtë përmbajtje: *“Kur blerësi është subjekt i ndryshëm nga KESH/FPSH impiantet prodhues duhet të deklarojnë programet e tyre të lëvrimit dhe kontratat përkatëse për ditën në avancë”, si dhe planifikimin vjetor ku përcakton sasinë e energjisë elektrike që shitësi do të shes në KESH sh.a., dhe në tregun e pa rregulluar të energjisë elektrike. Ky planifikim dërgohet në KESH sh.a. brenda datës 30 Nëntor të vitit aktual për vitin pasardhës. Nominimi i programit përkatës do të bëhet në përputhje me rregullat e tregut të energjisë elektrike.*

Ne nenin 5, pas pikës 5.3, shtohet pika 5.3/i, me këtë përmbajtje: *“Kur blerësi është subjekt i ndryshëm nga KESH/FPSH, ndaj impianteve prodhues zbatohen Rregullat e Tregut mbi Disballancat”.*

Ne nenin 6, pas pikës 6.2 te shtohet pika 6.2/i, me këtë përmbajtje: *“Kur prodhuesi/shitësi vendos të operojë si në tregun e rregulluar si në tregun e pa rregulluar, impiantet*

prodhuese duhet te jene te pajisur me sistem telematje me baze orare te integruar me sistemin e matjes se OST'.